



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 3166 prot

Vlorë më 09/10 /2018

VENDIM

Nr 32 datë 28.09 2018

PËR

TRANSFERIM AKTIVESH BASHKISË VLORË

Këshilli i Qarkut Vlorë, në mbledhjen e datës 28 / 09 /2018 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës (ngritur me urdhër nr. 73 dt. 13/09/2018) për transferimin e aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, inventar ekonomik (llog 218) dhe aktive qarkulluese, inventar i imët (llog. 32) Bashkisë Vlorë, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore,,
- Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore,,
- Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,, me ndryshime, si dhe pikës 108/a të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorik publik,, me ndryshime.

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e A.Q.T.inventar ekonomik(llogaria 218) në vlerë 7.367.804 lekë nga Këshilli i Qarkut Vlorë në Bashkinë Vlorë.
2. Të miratojë transferimin e A.Qarkulluese (llogaria 32) në vlerë 45.200 lekë nga Këshilli i Qarkut Vlorë në Bashkinë Vlorë.
3. Transferimi i pikës 1 dhe pikës 2. do të do të jenë sipas pasqyrës bashkëngjitur:
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kabineti dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.